


“PINGPONGU” ME TENDERIN 5 MILIONËSH PËR SPITALIN NË PRIZREN

(RAST STUDIMI)



TRANSPARENCY AND
ANTI-CORRUPTION



“PINGPONGU”

ME TENDERIN 5 MILIONËSH PËR SPITALIN NË PRIZREN

(RAST STUDIMI)

**QERSHOR 2021
PRISHTINË**

COPYRIGHT © 2021.

Kosova Democratic Institute (KDI). Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 237,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Kosovë. Opinonet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

KRONOLOGJIA E TENDERIT

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) në korrik të vitit 2019 kishte shpallë tenderin për ndërtimin Obje­k­tit Spitalor për Nënë dhe Fëmijë në Prizren.¹ Vlera e parashikuar e këtij tenderi ishte 5,561,392,47 euro. Ndonëse me rëndësi jetike për qytetarët e Prizrenit, procesi i prokurimit për këtë projekt - nga shpallja e tenderit e deri në nënshkrimin e kontratës - kishte zgjatur plot 428 ditë.² Kjo si pasojë e ankesave të vazhdueshme të ofertuesve lidhur me vlerësimin e drejtë të ofertave të pranuar.

KDI kishte filluar analizimin e këtij tenderi, pikërisht pasi kishte vërejtur se procesi po përcillej me shumë ankesa nga kompanitë ofertuese, të cilat pastaj po prodhonin vendime të njëpasnjëshme, shpesh edhe kontradiktore, sa nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), sa nga SHSKUK. Në mes këtij "ping-pong-u" të vendim-marrjes institucionale, qëndronin ankesat e tenderuesve lidhur me përmbushjen e kriterëve të dosjes së tenderit, më saktësisht (pa)përgjegjshmërinë e operatorëve ekonomik ofertues karshi tenderit.

Pas shpalljes së këtij tenderi, SHSKUK (si autoritet kontraktues) dhe OSHP nuk kishin pranuar asnjë ankesë lidhur me kushtet dhe kërkesat të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë/Dosje të Tenderit. Megjithatë, KDI kishte vërejtur se ndonëse SHSKUK kishte shkurtuar afatin e rregullt për dorëzimin e ofertave për prokurime të vlerës së madhe nga 40 në 30 ditë, kjo e fundit nuk kishte dhënë arsyetimin pse kishte devijuar nga kjo kërkesë ligjore.³

IV.3.2) Afati i fundit për pranim të tenderëve / aplikacioneve:

data 30.08.2019 koha 13:00:00 vendi Ne platformen elektronike E-prokurimi

IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar:

☒ Po ☐ Jo

Nëse po, jep arsyetim

¹ Tenderi me numër të prokurimit 00220-19-5304-5-1-1, 31 korrik 2019

² Kontrata me numër identifikues 00220-19-5304-5-1-1, e nënshkruar nga SHSKUK me 29.09.2020 dhe OE me 30.09.2020

³ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, 21. Afatet kohore, fq. 43

"PINGPONGU"

ME TENDERIN 5 MILIONËSH PËR SPITALIN NË PRIZREN

SHSKUK

31 korrik 2019 SHSKUK shpall tenderin "Ndërtimi i Objektivit Spitalor për Nënë dhe Fëmijën në Prizren".

21 tetor 2019 SHSKUK anulon tenderin duke vlerësuar të gjitha ofertat e kompanive të papërgjegjshme.

24 dhjetor 2019 SHSKUK shpallë fitues kompaninë "Raf II" pas rivlerësimit të ofertave

08 prill 2020 SHSKUK shpallë fitues kompaninë "Hidroterm" pas rivlerësimit të ofertave

24 korrik 2020 SHSKUK shpallë fitues kompaninë "Raf II" pas rivlerësimit të ofertave

30 korrik 2020 SHSKUK aprovon kërkesën e "Hidroterm" për rishqyrtim si të bazuar dhe shpallë fitues kompaninë "Hidroterm". Kërkesa e Hidroterm për rishqyrtim të vendimit nga SHSKUK pretendonte se kjo kompani ka plotësuar kërkesën për deklaratat tatimore në ATK. "Hidroterm" poashtu potenconte se oferta e tij kishte çmimin më të lirë.

22 shtator 2020 SHSKUK publikon Njoftimin për Dhënie të Kontratës për "Hidroterm" në e-prokurimi.

30 shtator 2020 SHSKUK nënshkruan kontratën me Hidroterm.

OSHP

10 dhjetor 2019 OSHP e aprovon si të bazuar ankesën e kompanisë "Raf II" e cila pretendonte se kishte plotësuar kërkesën e Dosjes së Tenderit, që: "kompania të ketë realizuar kontrata gjatë 3 viteve të fundit në vlerë jo më pak se 8 milion euro", për të cilën arsye fillimisht ishte eliminuar. OSHP e ktheu lëndën në rivlerësim në SHKSUK.

11 mars 2020 OSHP aprovon si pjesërisht të bazuar ankesën e kompanisë "Hidroterm", e cila pretendonte të ketë plotësuar kërkesën e Dosjes së Tenderit, që: "kompania të ofroj deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) për tri vitet e fundit në vlerë jo më pak se 8 milion euro", për të cilën arsye ishte eliminuar. OSHP e ktheu lëndën në rivlerësim në SHSKUK.

15 qershor 2020 OSHP aprovon ankesën e kompanisë "Raf II" si pjesërisht të bazuar ku pretendimi i "Raf II" ishte se "Hidroterm" nuk plotëson kërkesën për "deklaratat tatimore në ATK për tri vitet e fundit në vlerë jo më pak se 8 milion euro".

18 shtator 2020 OSHP edhe pse aprovon ankesën e kompanisë "Raf II" si pjesërisht të bazuar, merr vendim përmes të cilit lejon SHSKUK-së të vazhdojë me dhënie të kontratës për kompaninë "Hidroterm". Ankesa e "Raf II" insistonte që "Hidroterm" nuk kishte plotësuar kërkesën për: "deklaratat tatimore në ATK"



KDI kishte filluar analizimin e këtij tenderi, pikërisht pasi kishte vërejtur se procesi po përcillej me shumë ankesa nga kompanitë ofertuese, të cilat pastaj po prodhonin vendime të njëpasnjëshme, shpesh edhe kontradiktore, sa nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), sa nga SHSKUK. Në mes këtij "ping-pong-u" të vendim-marrjes institucionale, qëndronin ankesat e tenderuesve lidhur me përmbushjen e kriterëve të dosjes së tenderit, më saktësisht (pa)përgjegjshmërinë e operatorëve ekonomik ofertues karshi tenderit.

Kontrata është nënshkruar 6 ditë pas njoftimit për dhënie të kontratës, ndërsa sipas Ligjit për Prokurimin Publik, neni 26 pika 4.1 nënshkrimi i kontratave publike bëhet "së paku dhjetë (10) ditë pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës".

Për këtë tender SHSKUK kishte pranuar pesë oferta me çmimet si në vijim:⁴

Nr i prokurimit		00220-19-5304-5-1-1
Numri i brendshëm		220 19 048 511
Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave¹
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik ADA CONSULTING GROUP SH.P.K.; AL TRADE HOLDING L.L.C., ARBËRI NORA E HOTIT,BLL.C2-10,OBJ."B"HI-4/2, -. PRISHTINË	5.514.085,70 €
2.	"PE -VLA-KU" SH.P.K. DEGA NË KOSOVË, Rr. Jakov Xoxa, Ll. A, Kati 7, nr. 54, 10000, PRISHTINË	8.546.666,25 €
	Grup i Operatorëve Ekonomik „Raf II sh.p.k.; KAG - Asphalt Company Sh.p.k., Xhelal Hajda Toni, 21000, Kosovo	5.044.388,89 €

Fig. 1 – Tabela e ofertuesve për aktivitetin e prokurimit me nr. 00220-19-53-5-1-1

Megjithatë, pas vlerësimit të pesë ofertave të pranuar, SHSKUK në tetor 2019 kishte publikuar vendimin sipas të cilit asnjëra ofertë nuk ishte e përgjegjshme⁵ andaj ky aktivitet i prokurimit do të anulohet⁶. Sipas vlerësimit të SHSKUK këto oferta ishin të papërgjegjshme për arsyet si në vijim:

#	Ofertuesi	Arsyeja
1	Grup i Operatoreve Ekonomik ADA CONSUL TING GROUP SH.P.K.; AL TRADE HOLDING L.L.C., ARBERI NORA E HOTIT,BLL.C2-10,OBJ."B"HI-4/2, -. PRISHTINE	1. OE nuk kishte ofruar kontrata valide të kryera brenda 3 viteve të kaluara në vlerën e kërkuar; 2. OE nuk kishte ofruar dëshmitë e kërkuara për inxhinjerin e diplomuar të ndërtimtarisë.
2	"PE -VLA-KU" SH.P.K. DEGA NE KOSOVE, Rr. Jakov Xoxa, Ll. A, Kati 7, nr. 54, 10000, PRISHTINE;	Oferta ishte refuzuar sepse kishte tejkaluar në mënyrë substanciale buxhetin e parashikuar për këtë qëllim.
3	Grup i Operatoreve Ekonomik „Raf II sh.p.k.; KAG - Asphalt Company Sh.p.k., Xhelal Hajda Toni. 21000, Kosovo	OE nuk kishte ofruar kontrata valide të kryera brenda 3 viteve të kaluara në vlerën e kërkuar.
4	N.P.N. "HIDROTERM" SH.P.K, Brigada 123, 23000, Suhareke	1. OE nuk kishte përmbushur vlerën e kërkuar të deklarimeve të kryera të qarkullimit në ATK për vitet e kërkuara; 2. OE nuk kishte ofruar kontrata valide të kryera brenda 3 viteve të kaluara në vlerën e kërkuar.
5	Grup i Operatoreve Ekonomik Olti Trasing SH.P.K.; ALBA GROUP SH.P .K., Bill Klinton, 10000, PRISHTINE	1. OE nuk kishte ofruar kontrata valide të kryera brenda 3 viteve të kaluara në vlerën e kërkuar; 2. OE nuk kishte ofruar kontratë valide për një referencë mbi vlerën 1.5 milion; 3. OE nuk kishte ofruar dokumentacionin për inxhinjerin e arkitekturës.

Tabela 1. Arësyet e dhëna nga SHSKUK për shpalljen e ofertave si të papërgjegjshme

4 1) Grup i Operatoreve Ekonomik ADA CONSUL TING GROUP SH.P.K.; AL TRADE HOLDING L.L.C., ARBERI NORA E HOTIT,BLL.C2-10,OBJ."B"HI-4/2, -. PRISHTINE; 2) "PE -VLA-KU" SH.P.K. DEGA NE KOSOVE, Rr. Jakov Xoxa, Ll. A, Kati 7, nr. 54, 10000, PRISHTINE; 3) Grup i Operatoreve Ekonomik „Raf II sh.p.k.; KAG - Asphalt Company Sh.p.k., Xhelal Hajda Toni. 21000, Kosovo; 4) N.P.N. "HIDROTERM" SH.P.K, Brigada 123, 23000, Suhareke; dhe 5) Grup i Operatoreve Ekonomik Olti Trasing SH.P.K.; ALBA GROUP SH.P .K., Bill Klinton, 10000, PRISHTINE

5 Bazuar në raportin e Komisionit për vlerësim, ekzaminim dhe krahasim të tenderëve, të datës 18.10.2019

6 [NJËFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, Nr. i Prokurimit 00220-19-5304-5-1-1, nënshkruar me 18 tetor 2019, dhe publikuar në e-prokurimi me 21 tetor 2019](#)

|||||

Ndaj këtij vendimi, tre ofertues kishin parashtruar kërkesa për rishqyrtim të vendimit në SHSKUK⁷. Të tre këta ofertues kishin kundërshtuar vlerësimin e SHSKUK-së për mospërbushjen e kriterit të përshtatshmërisë ekonomike lidhur me qarkullimin vjetor financiar për tre vitet e fundit. Ky kriter parasheh qarkullim në vlerë prej jo më pak se 8 milion euro për tre vitet e fundit fiskale dhe kjo e dëshmuar në Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të **Kosovës**⁸.

Numri i Prokurimit: 00220-19-5304-5-1-1 – Titulli: Ndërtimi i Objektivit Spitalor për Nënë dhe Fëmijën në Prizren			
		Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se qarkullimi vjetor i tij, gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit për kontratë ka qenë gjithsej jo më pak se 8,000,000.00 €. Lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të qarkullimit minimal. [Bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, 10.04.2019, pika 27.4 (shih faqe 67)].	Dëshmia 1. Qarkullimi bankar për tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontratë jo më pak se 8,000,000.00 € (original të vërtetuar nga banka). Dëshmia 1.1. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit të përfunduara fiskale nga data e njoftimit për kontratë jo më pak se 8,000,000.00 €(kopje).

Fig. 2. Ekstrakt nga Dosja e Tenderit lidhur me kërkesën dhe dëshminë për qarkullimin financiar

Me datën 29 tetor 2019, SHSKUK kishte refuzuar të tri kërkesat e operatorëve për rishqyrtim si të pa bazuara, meqë sipas SHSKUK asnjëri nga këta ofertues nuk kishte ofruar dëshmi të qarkullimit vjetor prej jo më pak se tetë milion euro gjatë tre viteve të fundit (korrik 2016 – korrik 2019) siç kërkohej në dosje të tenderit⁹, dhe kishte proceduar me vendimin për anulim të këtij tenderi¹⁰.

Që nga nëntori 2019 deri në shtator 2020 ky aktivitet i prokurimit ishte në proces ankimor, herë në SHSKUK herë në OSHP. Gjatë gjithë kësaj periudhe ankesat në vazhdimësi ishin nga dy Operatorë Ekonomikë (Raf II dhe "Hidroterm") dhe çdoherë ai i cili ankohej në OSHP kishte të drejtë dhe lënda kthehej në rivlerësim.

7 1) Grup i Operatoreve Ekonomik ADA CONSUL TING GROUP SH.P.K.; AL TRADE HOLDING L.L.C., ARBERI NORA E HOTIT,BLL.C2-10,0BJ:"B"HI-4/2, -, PRISHTINE; 2) Grup i Operatoreve Ekonomik „Raf II sh.p.k.; KAG - Asphalt Company Sh.p.k., Xhelal Hajda Toni. 21000, Kosovo; dhe 4) N.P.N. "HIDROTERM" SH.P.K, Brigada 123, 23000, Suhareke.

8 [Dosja e tenderit, Nr. i prokurimit 00220-19-5304-5-1-1](#), 30 korrik 2019, e qasur së fundmi me 25 maj 2021.

9 1) Përgjigjeje në kërkesën për rishqyrtim Ada Consulting & Al Trade Holding, publikuar në e- prokurimi me 29.10.2019 dhe I qasur së fundmi me 25.05.2021; 2) Përgjigjeje në kërkesën për rishqyrtim NPN"Hidroterm publikuar në e- prokurimi me 29.10.2019 dhe I qasur së fundmi me 25.05.2021; dhe 3) Përgjigjeje në kërkesën për rishqyrtim"RAF-II"Sh.P.K. publikuar në e- prokurimi me 29.10.2019 dhe I qasur së fundmi me 25.05.2021

10 Vendimi mbi pezullimin e aktivitetit i datës 24.10.2019

|||||



Fig. 3. Ekstrakt nga e-Prokurimi

Të pakënaqur me vendimin e parë të SHSKUK¹¹, Grup i Operatoreve Ekonomik „Raf II sh.p.k. dhe KAG - Asphalt Company Sh.p.k. kishin parashtruar një ankesë pranë OSHP-së¹² duke kontestuar vlerësimin e bërë nga SHSKUK sipas të cilit ishte shpallur i papërgjegjshëm. Këtë ankesë e kishte mbështetur edhe eksperti shqyrtues i lëndës i caktuar nga OSHP¹³, ndërsa në dhjetor 2019, paneli shqyrtues i OSHP-së kishte vlerësuar këtë ankesë të operatorit si të bazuar dhe kishte anuluar vendimin e SHSKUK-së për anulim të tenderit. Poashtu kishte kërkuar që lënda kthehej në ri-vlerësim në SHSKUK¹⁴.

Pas kësaj, në fund të dhjetorit të vitit 2019, komisioni i SHSKUK-së i mbledhur për të rishqyrtuar ofertat për këtë tender kishte vlerësuar se nga pesë ofertat e pranuar, vetëm një, ajo e Grupit të Operatoreve Ekonomik „Raf II sh.p.k. dhe KAG - Asphalt Company Sh.p.k. ishte e përgjegjshme dhe ishte rekomanduar për dhënie të kontratës¹⁵.

Ndaj këtij vendimi menjëherë kishte pasuar ankesa e operatorit N.P.N. „Hidroterm” Sh.p.k.¹⁶, i cili ndër të tjera pretendonte se SHSKUK nuk e kishte vlerësuar drejtë ofertën e tij, dhe se nuk e kishte marrë për bazë qarkullimin e kompanisë për aktivitetet e realizuara në Mal të Zi, meqë ato nuk mund të paraqiteshin në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) siç ishte kërkuar të dëshmohej në dosjen e tenderit. Në përmbushje të kërkesës prej 8 milion Euro qarkullim për tre vitet e fundit „Hidroterm” Sh.p.k. kishte prezantuar dy dëshmi, atë të qarkullimit të deklaruar në ATK në vlerë prej 6,106,228.67 EURO si dhe 1,913,110.00 EURO dëshmi të qarkullimit bankar nga NLB Banka në Mal të Zi, e që gjithsej arrinin vlerën e qarkullimit prej 8,019,338.67 EURO qarkullim për periudhën 2016 -2018.

¹¹ Vendimi i datës 29 tetor 2019

¹² Ankesa me numër 772/19 e datës 01.11.2019.

¹³ Raporti i ekspertit shqyrtues me numër 772/19, i datës 18.11.2019

¹⁴ Vendimi i OSHP-së PSH.nr. 772/19 i datës 10.12.2019

¹⁵ Raporti i ri-vlerësimit të tenderëve i SHSKUK i datës 24.12.2019

¹⁶ Kërkesa për rishqyrtim e deponuar nga N.P.N. „HIDROTERM” SH.P.K, Brigada 123, 23000, Suhareke, me 31.12.2019 (sipas vendimit të SHSKUK të datës 06.01.2020)

Fig. 4. Ekstrakt nga Ankesa e Hidroterm Sh.p.k. e deponuar në OSHP lidhur me mos pranimin e qarkullimit financiar në Mal të Zi

Edhe ndaj këtij vendimi, OE RAFI II parashtrroi ankesë në SHSKUK ku pretendohet se SHSKUK po shkilte kriteret e dosjes së tenderit duke marrë vendim që t'ia jipte kontratën një operatori ekonomik i cili nuk i plotësonte kushtet e parashtruara të përshtatshmërisë²², por e cila ankesë u refuzua nga ky SHSKUK si e pabazuar²³. Ndaj vendimit të SHSKUK, me 17 prill 2020 i njëjti operator deponoi ankesë në OSHP²⁴ me pretendimin që operatori Hidroterm" Sh.p.k. nuk përmbushte kërkesën për deklarimin e qarkullimit në ATK në vlerë prej 8 milion eurosh siç kërkohej në dosjen e tenderit. Për më tepër, operatori RAFI II në ankesën e tij kishte ngritur dyshime për mospërputhjen e shumave të qarkullimit të deklaruar në ATK dhe dëshmive bankare dhe ekspertizën e dhënë lidhur me rastin, respektivisht trajtimin jo të njëjte gjatë trajtimit të rastit nga OSHP. Pas shqyrtimit të ankesës, me 15 qershor 2020, OSHP aprovoi ankesën si pjesërisht të bazuar dhe ktheu përsëri lëndën në rivlerësim në SHSKUK²⁵. Sipas vendimit të OSHP-së, Hidroterm" Sh.p.k. (Kosovë) dhe "Hidroterm-BK" DOO (Mal i Zi) ishin dy biznese të ndryshme meqë kishin numër të ndryshëm të regjistrimit dhe nuk kishin lidhur një marrëveshje konsorciumi për tenderin në fjalë, si dhe po i njëjti nuk kishte përmbushur kriterin e dosjes së tenderit i formuluar decidivisht si **"Deklarata Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK)"**, meqë rast kjo kompani nuk kishte përmbushur kriterin ekonomik të qarkullimit prej 8 milion eurosh në tre vitet e fundit (2016-2018).

17 [Përgjigjeje në kërkesën për rishqyrtim, SHSKUK, 06.01.2020](#), I qasur për herë të fundit me 25.05.2021
18 Ankesa në OSHP me nr. 39/20, e datës 16.01.2020
19 Raporti I ekspertit shqyrtues të OSHP-së, Nr. 39/20 I datës 31.01.2020
20 Vendimi I OSHP-së Nr. 39/20
21 [E-prokurimi: 00220-19-5304-5-1-1 B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK. 220- 19- 048- 511, 08.04.2020, I qasur për herë të fundit me 25.05.2021](#)
22 Ankesa e deponuar në SHSKUK e datës 13.04.2020
23 [E-prokurimi: 00220-19-5304-5-1-1 Vendim për refuzim të kërkesës për rishqyrtim 15.04.2020, I qasur për herë të fundit me 25.05.2021](#)
24 Ankesa në OSHP me nr. 253/20
25 Vendimi OSHP-së.nr. 253/20

Edhe ndaj këtij vendimi të SHSKUK, menjëherë kishte reaguar Hidroterm" Sh.p.k. dhe për dallim nga herat tjera, SHSKUK këtë herë kishte vendosur t'a pranoj si të bazuar ankesën²⁶. Pas shqyrtimit të menjëhershëm të ankesës²⁷, SHSKUK kishte bërë edhe rivlerësimin dhe kishte publikuar vendimin për dhënie të kontratës kompanisë Hidroterm" Sh.p.k.²⁸

Kësaj here, si pjesë të ankesës së tij, OE "Hidroterm" kishte bashkëngjitur edhe opinionet e dhëna nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP)²⁹ lidhur me kërkesën e tyre për interpretim ligjor.




Fig. 5. Foto e e-mailit të KRPP-së me interpretimin ligjor të kërkesave të "Hidroterm" Sh.p.k. faqja 1

26 E-prokurimi: 00220-19-5304-5-1-1 Vendim mbi aprovimin e kërkesës për rishqyrtim, 30.07.2020, i qasur për herë të fundit me 25.05.2021

27 Rivlerësimi nga SHSKUK i datës 30.07.2020

28 E-prokurimi: 00220-19-5304-5-1-1 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, 30.07.2020, i qasur për herë të fundit me 25.05.2021

29 Kërkesë për interpretim nga Hidroterm Sh.p.k. – 17.06.2020

|||||




Fig. 6. Foto e e-mailit të KRPP-së me interpretimin ligjor të kërkesave të "Hiroterm" Sh.p.k. faqja 2

|||||

Kërkesa e parashtruar për interpretim në KRPP nga Hidroterm" Sh.p.k. kishte të bëjë me Nenet 68.4³⁰, 69.8³¹ 71³² dhe 65.4.8³³ të LPP-së. Ky interpretim ishte përdorur nga SHSKUK si bazë për marrë vendim³⁴ i cili në fat përbën "shmangie" të kriterit të dosjes së tenderit që kërkon që qarkullimi financiar të dëshmojë në mënyrë taksative me **vërtetim** nga **Administrata Tatimore e Kosovës**³⁵.

Për më shumë, KDI kishte gjetur se ky opinion i dhënë nga KRPP nuk ishte i publikuar në uebfaqe të saj, tek seksioni pyetjet e shpeshta³⁶.

Ndaj këtij vendimi të SHSKUK, operatori RAFI II ishte ankuar në OSHP³⁷, ankesë kjo e cila u vlerësua nga OSHP si pjesërisht e bazuar. Pavarësisht kësaj, OSHP në vendimin e saj vërtetoi njoftimin për dhënie të kontratës nga SHSKUK, sipas të cilit Hidroterm" Sh.p.k. ishte fituese e kontratës në vlerë prej 5 milion euro.

Pas një serie maratonike vendimesh e anulimesh nga SHSKUK dhe OSHP dhe përkundër që baza kryesore e të gjitha ankesave të operatorëve ishte **deklarata (vërtetimi) nga Administrata Tatimore e Kosovës**, KDI nuk ka gjetur në asnjë moment evidencë që tregon se SHSKUK apo OSHP i janë drejtuar ATK-së, si organ kompetent lidhur me administrimin e taksave në Kosovë, për të marrë sqarime lidhur me qarkullimin e deklaruar nga operatori.

KDI në kuadër të analizimit të këtij aktiviteti prokurimi, i ishte drejtuar ATK-së me kërkesë³⁸ për sqarim dhe nga ATK kishte pranuar përgjigjen se nuk ekzistonin të dhëna lidhur me "Hidroterm-BK D.O.O." pasi ky biznes operonte në Republikën e Malit të Zi³⁹. ATK njoftoi se tatimi i deklaruar për 3 vite (2016-2018) nga NPN "Hidroterm" ishte 6,106,228.67€.

30 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 68 - Gjendja Ekonomike dhe Financiare, Paragrafi 4: *Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai duhet në këtë rast të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete për këtë qëllim. Në kushte të njëjta, një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup të subjekteve të tjera*

31 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, paragrafi 8: *Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera.*

32 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 71 - Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik

33 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 65 - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, **paragrafi 4**. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, **paragrafi 4.8**, aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;

34 Vendimi i SHSKUK-së i datës 24.07.2020

35 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; **Neni 67 Provat Shkresore: Paragrafi 2**. *Autoriteti kontraktues e s'kualifikon çdo kandidat ose tenderues që nuk paraqet: (i) certifikatat ose dëshmitë e nevojshme për të treguar ose konfirmuar se ai nuk shkualifikohet sipas nenit 65 të këtij ligji, (ii) certifikatë, dokument ose ndonjë provë tjetër të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme kërkohet nga autoriteti kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji me qëllim të verifikimit të përshtatshmërisë profesionale të kandidatit ose tenderuesit, ose (iii) prova të mjaftueshme, sipas nenit 68 dhe 69 të këtij ligji, që në mënyrë të arsyeshme tregojnë së kandidati ose tenderuesi i plotëson kushtet minimale financiare, teknike dhe profesionale të përcaktuara në dosjen e tenderit ose në njoftimin e kontratës. **Neni 68 - Gjendja Ekonomike dhe Financiare Paragrafi 2**: Autoriteti kontraktues do të specifikojë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tender ose pjesëmarrje, se cilat nga referencat e sipërpërmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dhe/ose referencat e tjera kërkohen prej tij; **Neni 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**, Paragrafi 1: *Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes: 1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji; 1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.**

36 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 87 Funkcionet Themelore të KRPP-së, Paragrafi 2.8 **të nxjerrë dhe publikojë interpretime me shkrim** të vendimeve administrative për të dytat, autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji dhe çdo dokumenti të nxjerrë nga KRPP-ja

37 Ankesa e deponuar në OSHP me nr. të protokollit 561/20, 12.08.2020

38 Kërkesa e dërdur përmes postës elektronike e datës 24 gusht 2020, ora 12:48 PM

39 E-maili nga Administrata Tatimore e Kosovës, i datës 25 gusht 2020, ora 10:01

Sipas legjislacionit në fuqi⁴⁰ në kohën e zhvillimit të aktiviteteve të "Hidroterm-BK D.O.O." në Mal të Zi, të prezantuara si dëshmi në dosjen e tenderit⁴¹, kompanitë e Kosovës ishin të obliguara të deklarojnë në ATK edhe qarkullimin e realizuar nga degët e tyre të cilat operonin jashtë vendit.

KDI kishte gjetur se Hidroterm" Sh.p.k. nga Suhareka ishte pronare e vetme e degës në Mal të Zi, e themeluar në nëntor 2011.

Por, KDI gjithashtu kishte gjetur se me datën 22.04.2019, respektivisht tre muaj para shpalljes së tenderit, Gjykata Tregëtare e Malit të Zi kishte marr vendim⁴² të fillonin procedurat e falimentimit të kompanisë "Hidroterm-BK" D.O.O. për shkak të mungesës së qarkullimit të kësaj kompanie dhe **borxheve të pa shlyera ndaj Administratës Tatimore të Malit të Zi.**

Crna Gora
PORESKA UPRAVA
SEKTOR ZA USLUGE I REGISTRACIJU
ODJEL ZA CENTRALNI REGISTAR PRIVREDNIH SUBJEKATA

Prijemljen: 23/04/19 preko pošte
Dana: 23/04/19 Predato na poštu dana: 23/04/19
Predloženo: 03/2-1-694/L-19
Bilježak: Bilježak o prijavi stečajnog postupka

St.br.469/19

PRIVREDNI SUD CRNE GORE, sudija Milica Vlahović, odlučujući po predlogu za otvaranje stečajnog postupka podnijetom sudu dana 22.03.2019.godine, a koji je uređen podneskom od 09.04.2019.godine, nad privrednim društvom „HIDROTERM-BK“ DOO Ulcinj, /mat.br. 02837447/, Ulica 26.novembra, koga zastupa punomoćnik Nebojša Golubović, advokat iz Podgorice, dana 22.04.2019.godine, donio je

RJEŠENJE

OTVARA SE stečajni postupak nad stečajnim dužnikom „HIDROTERM-BK“ DOO Ulcinj, /mat.br. 02837447/, Ulica 26.novembra.
Za stečajnog upravnika imenuje se Danilo Aćimić

Povjerioci se pozivaju da u roku od 30 dana od dana objave Oglasa o otvaranju stečajnog postupka, prijave svoja obezbijedena i neobezbijedena potraživanja.

Dužnici se pozivaju da ispune svoje obaveze prema stečajnoj masi.

Prvi sastanak povjerilaca održaće se dana 06.06.2019.godine sa početkom u 10:15 časova, a ročište za ispitivanje potraživanja dana 13.06.2019.godine u 10:15 časova u Privrednom sudu Crne Gore, kancelarija br.13.

Nalaže se Centralnom registru privrednih subjekata Crne Gore da upiše stečajnog upravnika, kao nosioca zastupničkih i upravljačkih prava nad stečajnim dužnikom, te da obriše imena lica koja su do dana otvaranja stečaja bili nosioci tih prava.

Rješenje se objavljuje na oglasnoj tabli suda dana 22.04.2019.godine.

Obrazloženje

Pisanim predlogom osnivača stečajnog dužnika od 22.03.2019.godine, a koji je uređen podneskom od 09.04.2019.godine, predloženo je pokretanje stečajnog postupka nad dužnikom „HIDROTERM-BK“ DOO Ulcinj, zbog trajne insolventnosti i

Fig. 7. Ekstrakt i vendimit të Gjykatës së Tregëtisë së Malit të Zi për falimentimin e "Hidroterm-BK" D.O.O. e protokolluar nga Administrata Tatimore e Malit të Zi

40 Ligjit Nr.05/L029 për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, neni 28 dhe UDHEZIMET ADMINISTRATIV MF-Nr. 02/2016 / PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 05/L-029 PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE - Neni 27 Shmangia e tatimeve të dyfishta 1. Tatimpaguesi i cili është rezident në Kosovë dhe përfiton të ardhura nga aktivitetet afariste jashtë Kosovës, për të cilat paguan tatimin në të ardhura në shtete tjera, i lejohe kreditimi tatimor për tatimin në të ardhura të paguar në shtetin tjetër, që i atribuohet të ardhurave të krijuara në shtetin tjetër.

41 Qarkullimi vjetor 2016-2017 i Hidroterm D.O.O. Mal I zi, e rexhistruar si degë e HIDROTERM SHPK, me adresë në Suharekë, Kosovë

42 PRIVREDNI SUD CRNE GORE, St. br. 469/19

Kjo shihej edhe nga raportet financiare të "HIDROTERM"-BK DOO të deklaruar në Ministrinë e Financave të Malit të Zi⁴³, të cilat pasqyrojnë probleme financiare të kësaj dege të "HIDROTERM" Sh.p.k. dhe sipas të cilave në vitin 2017 ndërmarrja kishte pasur një fitim minimal prej 0.37% ndërkohë që 43 % e mjeteve totale të ndërmarrjes në vitin 2017 i takonin borxhit⁴⁴.

Përfundimisht, SHSKUK më datën 30 shtator ka nënshkruar kontratën me OE "Hidroterm". KDI vlerëson se në këtë procedurë është shkelur neni 59.4⁴⁵ i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) dhe neneve 41.1⁴⁶, 41.3.5⁴⁷ dhe 41.5⁴⁸ të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik sepse OE fitues "Hidroterm" nuk i ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, ku janë kërkuar **Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit të përfunduara fiskale nga data e njoftimit për kontratë jo më pak se 8,000,000.00 €.**

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar taksativisht **që të deklarohet** qarkullimi financiar në Kosovë dhe nuk ishin definuar opsione të tjera të pranueshme si dëshmi të qarkullimit financiar të operatorëve ekonomik.

Po ashtu, KDI ka gjetur se SHSKUK kishte **bërë shkelje të LPP-së, pasi që** kontrata është nënshkruar 6 ditë pas njoftimit për dhënie të kontratës, ndërsa sipas LPP, neni 26 pika 4.1 nënshkrimi i kontratave publike bëhet **"së paku dhjetë (10) ditë pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës"**.

Për të analizuar në mënyrë më të detajuar ankesat maratonike lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, me **18 shtator 2020** kishte kërkuar nga SHSKUK qasje në dokumentet publike lidhur me tenderin për ndërtimin e këtij Spitali. Megjithatë, kjo qasje nuk ishte ofruar nga SHSKUK, me ç' rast KDI me 13 nëntor 2020 i ishte drejtuar Avokatit të Popullit me një ankesë ndaj këtij veprimi të SHSKUK. Vetëm pas reagimit të Avokatit të Popullit, KDI me **7 dhjetor 2020**, respektivisht 27 ditë pas nënshkrimit të kontratës, kishte pranuar dokumentet e kërkuara.

Në këto dokumente KDI kishte gjetur se "Hidroterm" Sh.p.k. në ofertën e saj kishte dorëzuar vetëm vërtetimin nga Gjykata Themelore, Departamenti për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë⁴⁹ se kompania nuk ishte e falimentuar apo në proces të falimentimit por nuk kishte dorëzuar edhe Çertifikatën nga Gjykata Themelore Departamenti për krime të Rënda⁵⁰ se kompania

43 Raportet Financiare nga Ministria e Financave Mal i Zi, të siguruar më 01 Tetor 2020

44 Analiza financiare e pavarur e raporteve financiare të Hidroterm-BK D.O.O., e datës 13 nëntor 2020

45 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, neni 59.4 i LPP-së: *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*

46 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve neni 41.1 i RrUOPP: *Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga OE do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i epet tenderuesit që ka renditjen më të lartë.*

47 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve neni 41.3.5 i RrUOPP: *Parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP janë: Vetëm kërkesat dhe kriteret e dhënies së kontratës të specifikuar në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdoren si bazë për vlerësim.*

48 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve neni 41.5 i RrUOPP: *Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.*

49 Çertifikata Agj.nr. 4530/19 e datës 31.07.2019

50 **Dosja e Tenderit 00220-19-5304-5-1-1, PJESA A: PROCEDURAT E TENDERIMIT; Seksioni I. INFORMACIONE PËR TENDERUESIT: Të Përgjithshme: Përshtatshmëria e operatorëve ekonomik (fq. 2):** 6.2 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ose ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të fundit: a. është shpallur fajtorë nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, mitosjen, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në nenin 130.1 të LPP-se sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare; b. është deklaruar i papërshtatshëm kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rreptshme profesionale, e konstatuar nga një gjykatë kompetente; c. është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale serioze të pjesëmarrjes në aktivitetet e një organizate kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme në vendin ku ndodhin ato; ose d. është shpallur

në fjalë nuk ishte dënuar për kryerjen e një vepre penale ose civile gjatë dhjetë viteve të fundit. Këto dy çertifikata, sipas LPP⁵¹ dhe Dosjes së Tenderit janë dokumente të obligueshme që duhet dorëzuar me ofertë.

Në tërë periudhën sa ka zgjatur ky proces i prokurimit, pronar i vetëm i kompanisë "Hidroterm", me 100% aksione⁵², ishte z. Blerim Kuçi. Ky i fundit, më 05 qershor 2020 kishte pranuar detyrën si Ministër i Ekonomisë dhe Mjedisit në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Bazuar në këtë fakt, KDI kishte ngritur dyshimet nëse dhënia e kontratës për Hidroterm, pronari i së cilës ishte tanimë një zyrtar i lartë publik, përbënte konflikt interesi dhe për këtë më 28 gusht 2020 i ishte drejtuar Agjencionit Kundër Korrupsion (AKK)⁵³.

Pas plot katër muajsh nga data e dorëzimit të kërkesës nga KDI dhe gati tre muaj pasi ishte nënshkruar kontrata me Hidroterm, AKK më 24 dhjetor 2020 ishte përgjigjur në kërkesë ku kishte vlerësuar se nuk kishte prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin për ekzistimin e mundshëm të konfliktit të interesit. Njëra nga arsyetimet e AKK-së për mungesën e provave për konflikt të interesit ishte që Blerim Kuçi nuk ishte pronar i "HIDROTERM" por ishte në zotim pasiv⁵⁴ të aksioneve ose i pjesëve në kapital.

Sidoqoftë, KDI kishte siguruar të dhënat nga ARBK se ndërrimi i pronësisë kishte ndodhur me 01 dhjetor 2020⁵⁵ derisa kërkesa e KDI-së për interpretim të konfliktit të interesit ishte në tavolinën e AKK-së.

Në anën tjetër, në ofertën e paraqitur nga Hidroterm, KDI kishte gjetur se Blerim Kuçi në fakt kishte deponuar CV-në bashkë me kualifikimet e tij si dëshmi për të përmbushur kriteret profesionale të dosjes së Tenderit, neni 9.1&9.2 si inxhinier i ndërtimtarisë/hidroteknik⁵⁶.

Konkludimi i përgjithshëm i KDI-së lidhur me këtë tender specifik qëndron në trajtimin jo-adekuat e joprofesional të lëndës nga të gjitha institucionet e involvuara padallim, SHSKUK, OSHP, AKK dhe KRPP.

fajtor për mashtrim apo një akt të ngjashëm me mashtrim nga një gjykatë kompetente; e. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale; ose f. është konstatuar nga një gjykatë kompetente se ka bërë keqinterpretime para autoriteteve publike në Kosovë ose diku tjetër.

51 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 65.3

52 ARBK ekstrakti i datës 08/26/2020

53 Lënda me nr. të protokolit DPKI – 06/1786/20

54 Ligji Nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, neni 3 Përkufizimet, Paragrafi 1.9 Zotërimi pasiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital – gjendja në të cilën pronari ruan të drejtën e përfitimit të fryteve të pronësisë, por nuk mund të ushtrojë vetë asnjë veprim tjetër mbi këtë pronë. Të gjitha veprimet e tjera si administrimi apo menaxhimi dhe drejtimi i ndërmarrjes kryhen nga personi i besuar nga pronari në emër të vet por për llogari të zyrtarit të lartë mbi bazën e një marrëveshje të lidhur ndërmjet tyre.

55 E-mail nga MTI i datës 11 mars 2020

56 Oferta e Hidroterm, Stafi për projektin, nënshkruar me 30.08.2019

|||||

SHTOJCA 1: KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË TENDER (EKSTRAKT I PAMODIFIKUAR NGA DOSJA E TENDERIT 00220-19-5304-5-1-1):

Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD)

Të dhënat e mëposhtme për punë që do të prokurohen do të plotësojnë, shtojnë, ose ndryshojnë dispozitat e Informatave për Tenderuesin. Kurdo që paraqitet ndonjë mospërputhje, këto dispozita do të mbizotërojnë mbi ato ne Informata për Tenderuesit.

[Udhëzimet për plotësimin e Fletës mbi të Dhënat e Tenderit janë shënuar me germa kursive për Nenet relevante të Informatave për Tenderuesit. Fshijini ato që nuk janë të nevojshme]

Udhëzimet për Tenderuesit		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante të Informatave për Tenderuesve
Përshkrimi i Nenit	Nr. i Nenit.	
Fusha e tenderit	1.1	Autoriteti Kontraktues (AK) është: Emri i AK: SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS Adresa e AK: Lagja e spitalit Qyteti: Prishtinë Kodi Postar: 10 000 Adresa Elektronike: www.shskuk.org Personi Kontaktues: Selami Krasniqi E-mail: selami.krasniqi@rks-gov.net Telefoni: 038/512/686 Faks:
	1.2	Titulli i kontratës dhe numri identifikues i aktivitetit të prokurimit është: Ndërtimi i Objektit Spitalor për Nënë dhe Fëmijën në Prizren 00220-19-5304-5-1-1
	1.3	Data e dorëzimit të Njoftimit të Kontratës në KRPP: 18.07.2019 Versioni i plotë i njoftimit të kontratës të dërguar në KRPP mund të shkarkohet nga faqja elektronike e KRPP-së ëëë.krpp.rks-gov.net
	1.4	Tenderi duhet të dorëzohet në adresen e përmendur në 23.1 përveç nëse nuk është e përmendur në 23.1 në adresen e përmendur në 1.1
Qëllimi i Kontratës	2.1	Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 45000000-7 <u>Qëllimi i kontratës është ekzekutimi i punëve ne vijim:</u> Ndërtimi i Objektit Spitalor për Nënë dhe Fëmijën në Prizren

|||||

|||||

Udhëzimet për Tenderuesit		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante të Informatave për Tenderuesve
Ndarja ne Lote	2.3	Ndarja ne Lote: Po ☐ Jo ☒ <i>Objekti i tenderit është i ndarë në pjesë (lote) shëno:</i> <u>Objekti i kontratës</u> është i ndare në 1 pjesë (lote). Tenderuesi mund të paraqesë tender për: ☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët Secila pjesë e lot-it është e shënuar në specifikacionet teknike , shih Aneksin 1. Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:
Vlera e parashikuar	2.4	5.561.392,47 €
Variantet	4.1	<i>Variantet autorizohen:</i> Po ☐ Jo ☒
Kushtet dhe kërkesat e dërgesës	5.1	Vendi i ekzekutimit te punëve është: Spitali i Përgjithshëm në Prizren
	5.2	Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: 3 Vite.

|||||

Udhëzimet për Tenderuesit		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante të Informative për Tenderuesve
Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik	6.4	Përveç deklarates se shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2, dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkojnë nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet Dokumentet të cilat do të kërkojnë si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë janë me se vijon: - Për situatën referuar pikës 6.2⁵⁷ [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3⁵⁸ [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. - Për situatën referuar pikës 6.3 [h (kontributi i sigurimit social), i dhe k] certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situatë tilla nuk ekziston. - Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës] Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.

57 **Dosja e Tenderit 00220-19-5304-5-1-1, PJESA A: PROCEDURAT E TENDERIMIT; Seksioni I. INFORMACIONE PËR TENDERUESIT; Të Përgjithshme: Përshtatshmëria e operatorëve ekonomik (fq. 2):** 6.2 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ose ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të fundit:

a. është shpallur fajtorë nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, mitosjen, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në nenin 130.1 të LPP-se sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;

b. është deklaruar i papërshtatshëm kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rende profesionale, e konstatuar nga një gjykatë kompetente;

c. është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale serioze të pjesëmarrjes në aktivitetet e një organizate kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme në vendin ku ndodhin ato; ose

d. është shpallur fajtor për mashtrim apo një akt të ngjashëm me mashtrim nga një gjykatë kompetente;

e. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale; ose

f. është konstatuar nga një gjykatë kompetente se ka bërë keqinterpretime para autoriteteve publike në Kosovë ose diku tjetër.

58 **Dosja e Tenderit 00220-19-5304-5-1-1, PJESA A: PROCEDURAT E TENDERIMIT; Seksioni I. INFORMACIONE PËR TENDERUESIT; Të Përgjithshme: Përshtatshmëria e operatorëve ekonomik (fq. 2, 3)** 6.3 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operator ekonomik:

a. gjatë dy (2) viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent, ose aktualisht është në procedurë: (i) të falimentimit, (ii) të pranimit të urdhrat për likuidim ose përmblyllje të aktiviteve ose administrimit nga gjykata ose (iii) ndonjë procedurë tjetër të ngjashme sipas ligjit të Kosovës ose ndonjë juridiksioni tjetër;

b. me vendim të një gjykate kompetente është likuiduar ose është vënë në mbikëqyrje të administratorit;

c. aktualisht ka një marrëveshje ose aranzhim me kreditorët e tij që siguron kushte të zgjeruara ose të reduktuara të pagimit nëse mbi kushtet e tilla janë pajtuar paraprakisht kreditorët e tillë për shkak se operatori ekonomik më parë ka qenë i paafët që të përmbushë obligimet e tij në afatin e duhur kohor;

d. është në një situatë të ngjashme me ato të përshkruara në nën-paragrafët a, b ose c të këtij paragrafi, që rrjedhin nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve në vendin ku është themeluar ose në vendin ku zhvillon veprimtarinë e tij afariste;

e. aktualisht i nënshtrohet një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon pagesat nga ose për një operatori të tillë ekonomik dhe që rezultojnë në një humbje të tërësishme ose të pjesshme të të drejtave të operatorit ekonomik për të administruar ose disponuar me pasurinë e tij;

f. aktualisht është lëndë e një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon ose redukon pagesat nga ose për operatorët e tillë ekonomik nëse procedurat e tilla gjithashtu mund të rezultojnë në vendimin për falimentimin ose likuidimin e operatorit ekonomik;

g. gjatë tri (3) viteve të fundit është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur një kontratë me ndonjë njësi publike, autoritet publik ose ndërmarrje në Kosovë ose diku tjetër;

h. aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;

i. është më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë me vonesë në pagimin e pagave të punonjësve ose në pagimin e obligimeve ndaj një operatori të shërbimeve publike në Kosovë;

j. ende nuk e ka zbatuar një vendim të lëshuar nga një gjykatë e Kosovës;

k. ka dhënë deklarata të rreme në lidhje me procedurën për dhënien e një kontrate publike, nëse këto kanë të bëjnë me mungesën e arsyeve për përjashtim, ose me përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes; ose

l. nuk është shpallu fajtor me një vendim të plotfuqishëm të miratuar në përputhshmëri me Nenin 99.2 të LPP-se.

|||||

Udhëzimet për Tenderuesit		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante të Informatave për Tenderuesve	
		Kërkesat e përshtatshmërisë: Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).	Dëshmia e kërkuar dokumentare: Evidenca 1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkohej nga tenderuesi të cilin QKUK ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të QKUK, për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do të konfiskohet garancioni i sigurimit të ofertës dhe QKUK do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë. Dokumentet të cilat do të kërkohej si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë janë me se vijon a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. (origjinali ose kopja e noterizuar) Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]. (kopje).
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale: Kërkesa 1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit , regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit. Kërkesa 2. Certifikatë e numrit fiskal . Kërkesa 3. Certifikatë e TVSh-së.	Dëshmia e kërkuar dokumentare: Evidenca 1. Te dëshmohet me Certifikatë të Regjistrimit të Biznesit si dhe me informacione të biznesit-Kopje Evidenca 2. Te dëshmohet me Certifikatë të Numrit Fiskal- Kopje Evidenca 3. Te dëshmohet me Certifikatë të TVSh-së Kopje.

|||||

Udhëzimet për Tenderuesit		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante të Informatave për Tenderuesve	
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar dokumentare
		Kërkesa 1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë një listë të kontratave të natyrës së ngjashme (ndertime të larta) të përfunduar me sukses në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontratë, të percjellur me referenca apo raporte të pranimit ku vlera e të cilave duhet të jete minimum: 8,000,000.00 € (Tetë Million Euro).	Dëshmia 1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi një listë të kontratave të natyrës së ngjashme (ndertime të larta) të përfunduar me sukses në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontratë, të percjellur me referenca apo raporte të pranimit ku vlera e të cilave duhet të jete minimum: 8,000,000.00 € (Tetë Million Euro). Lista duhet ti përmbajë të dhenat si: Daten e nënshkrimit, Daten e perfundimit, Titullin e Kontrates, Autoritetin Kontraktues, Vleren e projektit.
		Kërkesa 2. Kërkohen të dhëna për projektetë e implementuara, titulli i projektit si dhe vlera totale e projektit të realizuara gjatë tri viteve të fundit në vlerë jo më pak se 8,000,000.00 €.	Dëshmia 2. Të dëshmohet me kontrata dhe pranime teknike -së paku një referencë me vlerë 1,5 mil. Në fushën e ndërtimtarisë së lartë gjatë tri viteve të fundit të implementuara me sukses nga Operatori Ekonomik. Bazuar në LPP në fuqi, Neni 69 Aftësia Teknike dhe ose Profesionale, pika 2.1. (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërbën kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;
		Kërkesa 3. Menaxher i projektit- Inxhinier i dip. Ose kualifikimi Master i ndërtimtarisë ose i Arkitekturës me min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku tri (3) projekte me vlera të mdha (sipas kshatifikimit të kontratave të LPP-së)	Dëshmia 3. Për inxhinier Diploma (autoriteti rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit të kërkojë verifikimin e dokumenteve të ofruara), CV-të origjinal të nënshkruar nga inxhinieri (sipas formës së bashkangjitur me dosjen e tenderit), referencat. Kontrata marrëveshja e punës valide me punëdhënësin.
		Kërkesa 4. Menaxher i Punishtes - Inxhinier i dip. Ose kualifikimi Master i Ndërtimtarisë me min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar.	Dëshmia 4. Për inxhinier Diploma (autoriteti rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit të kërkojë verifikimin e dokumenteve të ofruara), CV-të origjinal të nënshkruar nga inxhinieri (sipas formës së bashkangjitur me dosjen e tenderit), referencat. Kontrata marrëveshja e punës valide me punëdhënësin.
		Kërkesa 5. Stafi i inxhinierve Një (1) inxhinier i Arkitekturë Një (1) inxhinier i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv Një (1) inxhinier i Ndërtimtarisë – drejtimi hidro Një (1) inxhinier i Elektros Një (1) inxhinier i Menakikës	Dëshmia 5. Inxhinierët të dokumentojnë diplomat universitare (kopje) master apo diploma me studime 5 vjeqare (autoriteti rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit të kërkojë verifikimin e dokumenteve të ofruara), përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit sipas profilin të drejtimit, CV , kontratë punes.
		Kërkesa 6 Listë të nënshkruar e vulosur me punonjësit e profileve të ndryshme për ndërtim.	Dëshmia 6. Lista e stafit me kualifikime profesionale dhe pregaditje shkollore minimum 30 puntorëtë profileve të ndryshme. Minimum një të certifikuar për saldamin e gypave në sistemin e gazrave medicinale (te dëshmohet me certificate të leshuar nga një institucion relevant)
		Kërkesa 7. Raportin për veglat dhe pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e projektit. Vegla dhe pajisje teknike në bazë të specifikave të projektit.	Dëshmia 7. Një deklaratë e nënshkruar dhe vulosur për veglat dhe pajisjet teknike në dispozicion për realizimin e projektit (origjinalin). Data e deklaratës nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë. Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit nëse e sheh të nevojshme të kërkojë verifikimin e tyre në vend.
		Kërkesa 8. Plani dinamik për egzekutimin e punëve.	Dëshmia 8. OE duhet të dërgoi dinamikën e kryesjes së punëve mbrenda 3 viteve.

|||||

Udhëzimet për Tenderuesit		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante të Informatave për Tenderuesve	
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
		Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se qarkullimi vjetor i tij, gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit për kontratë ka qenë gjithsej jo më pak se 8,000,000.00 €. Lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të qarkullimit minimal. [Bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, 10.04.2019, pika 27.4 (shih faqe 67)].	Dëshmia 1. Qarkullimi bankar për tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontratë jo më pak se 8,000,000.00 € (original të vërtetuar nga banka). Dëshmia 1.1. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit të përfunduara fiskale nga data e njoftimit për kontratë jo më pak se 8,000,000.00 € (kopje).
		Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 300 000 euro asete likuide financiare (për shembull në llogarinë bankare) ose të paktën 300 000 euro qasje për kredi në dispozicion.	Dëshmia 2. Deklarata nga banka që vërteton disponueshmërinë e 300 000 euro në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar origjinal (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të marrë kredi prej 300 000 eurove nëse është e nevojshme. Data e deklarates bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjale.
Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/ apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.	
Nënkontraktimet	12.1	a) një deklaratë ku deklarojnë nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit, dhe Të gjithë kontraktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.	
Siguria e tenderit	13.1	A është e nevojshme siguria e tenderit: Po ☐ Jo ☒	
	13.2	Vlera e sigurisë së tenderit 70 000 euro Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 90 apo muaj	
Siguria e ekzekutimit	14.1	Siguria e kërkuar e ekzekutimit: Po ☐ Jo ☒	
	14.2	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10% e vleres se Kontrates e vlefshme per 5 vite	
Sqarimi i Dosjes së Tenderit	16.1	20.08.2019	

|||||

Udhëzimet për Tenderuesit		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante të Informatave për Tenderuesve
Shkurtimi i afatit kohor	19.1	Për arsye të nevojave të mëdha të pacientëve për shërbime mjekësore, është paraqit nevojë e domosdoshme për një objekt të tillë në regionin e Prizrenit, në mënyrë që të kryhen të gjitha shërbimet mjekësore më afër qytëtarit, duke pas parasyshë numrin banorve që ka ky qytet, është nënvoj imedijate ndërtimi i Spitalit për Nënen dhe Fëmijen -Prizren. Duke u bazuar se ka pas shumë vonesa në regullimin e dokumantacionit tekinko administrativ, si dhe procedurave për përpilimin e projektit idor dhe detal për këtë qëllim. Zhvillimi i procedurave ka nevojë të përshpejtohet nga aspekti kohorë ashtu që në kohën sa më të shkurtër të mundshme të përfundon procesi i kontraktimit të ofruesve të shërbimit në mënyrë që të sigurohet në vijim performanca optimale dhe kontinuale e po të njëjtave. Prandajë në mënyrë që të kryhen sa më shpejt procedurat e prokurimit dhe të fillohet me egzekutimin e kontratës, kërkojmë që të lejohet shkurtimi i afateve për këtë procedurë. Në bazë të kësaj arsyeje kërkohet që të bëhet shkurtimi i afatit nga 40 në 30 ditë.
Periodha vlefshmërisë së tenderit	21.1	Periodha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 120 ditë.
Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	23.1	Afati i fundit për dorëzim është: 30.08.2019, 13:00:00 Vendi: Ne platformen elektronike E-prokurimi
Hapja e Tenderit	26.1	Hapja e tenderit do të bëhet me 30.08.2019, 13:00:00 Vendi: Zyra e prokurimit nr. 28
Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët];
Ankesat	31.3	[shëno adresën e AK-së]

